

## NË EMËR TË POPULLIT

### **GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i per gjithshem**

**Penal**, gjyqtari i vetem gjyqes Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit A Sh. nga Prizreni, për shkak të vepres penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KP-së, dhe mbrojtësit te tije av. Fitim Shporta nga Prizreni, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.3004/2015 të dt.07.12.2015, pas mbajtjes së seancës fillestare gjyqesore, në prezencën e Prokurorit Themelore te shtetit në Prizren Besim Susuri, të akuzuarit, me datë **20.12.2016**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari A Sh., nga i ati V., e ëma M., e vajzërisë M., i lindur më dt.27.04.1995 në Prizren, ku edhe tanj jeton ne pn., i pamartuar, ka të kryer shkollen filllore 6 vite, eshte i gjendjes se dobet ekonomike, i pa pune, shqiptar, shtetas i R. së Shqiperise.

### **E S H T Ë F A J T O R**

Se me dt.01.04.2014, ne ore te papercaktuar, ne punetorin e L. M., ne lagjen ne Prizren, me qellim te pervetsimit te kunderligjshem per vehte apo personin tjeter, merr pasurin e luajtshme-disqe (fellne) e te demtuarit G. P., ne ate menyre qe e shfrytezon rastin derisa i demtuari i kishte lën 4 disqe – fellne apo bandazh te gomave te vetures te tipit BMW, ne punetorin e lartecetur dhe largohet nga vendi i ngjarjes,

-kësodore ka kryer veprën penale te vjedhjes nga neni 325 par.1 të KP-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75 e 76 te KP-es dhe 365 të KPPK-ës, te akuzuarit i shqipton,

### **DENIM M E GJOBE**

Ne shumen prej **600 /gjashteqindë/ euro**, te cilen shume te denimit me gjobe i akuzuari eshte i obliguar te paguaj ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejti do te zevendesojet me denim burgu duke llogaritur per çdo 20 Euro nje dite burg, respektivisht 30 dite burgim, dhe

### **D E N I M M E B U R G**

Me kohezgjatje prej **2 /dy/ viteve**.

I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, sado qe te jen ato, ndersa në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **50 Euro**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfisqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I demtuari G S P nga Prizreni, per realizimin e kerkeses pasuroro – juridike udhezohet ne kontest te rregullt civilo-juridik,

### Arsy etim

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtuar aktakuzen me PP.nr.3004/2015 te dt.07.12.2015, kunder te akuzuarit A. Sh. nga Prizreni, per shkak te vepres penale vjedhje nga neni 325 par.1 te KP-es.

Prokurori i Shtetit ne Prizren Besim Susuri, ne fjalen e tije perfundimtare ka dekluaruar: me pranimin e fajesis ne menyre vullnetare nga ana e te pandehurit A. Sh. me pamedyshje vertetohen te dhenat si ne aktakuze se i pandehuri ka kryer vepren penale te vjedhjes nga neni 325 par.1 te KP-es. Pranimi i fajesis nga ana e gjykates duhet qe te mirret si rrethane lethesuese me rastin e caktimit te llojit dhe lartesis se denimit.

Mbrojtuesi i te akuzuarit av.Fitim Shporta ne fjalen e tij perfundimtare deklaron: pasi qe i akuzuari A. Sh. ka pranuar fajesin ne menyre vullnetare, propozojme qe gjykata gjate shqiptimit te denimit te merr parasysh rrethanat lethesuese te parapara ne nenin 73 par.3 te KP-es, e sidomos faktin se i njejti e ka pranuar fajesin vullnetarisht, eshte i moshes relativisht te re, i njejti eshte penduar per kete veper penale.

I akuzuari Arianit Shala ne fjalen e tij perfundimtare deklaron: ne teresi e mbeshtes fjalen perfundimtare te mbrojtuesit te tije av.Fitim Shporta dhe shton se per kete veper penale eshte i penduar dhe premton gjykates se ne te ardhmen nuk do te perseris keso vepre penale, sa i perket mallit disqeve – fellneve te njejtat te demtuarit iu jane kthyer.

Gjykata ne shqyrtim gjyqesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit A. Sh. i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, sa i perket vepres penale si ne dispozitivin e kesaj aktakuze, per vepren penale te vjedhjes, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesis per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajesis eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshitet ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njofuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhje ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale, te vjedhjes nga neni 325 par.1 te KP-se, gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor si ne dispozitivin nen 1 te aktakuzes dhe i shqiptoi denimin me gjobe dhe burgim, paraprakisht duke i vertetuar pergjegjesin e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke e gjetur si rrethane posaqerisht renduese, shkallen e pergjegjesis penale, intenzitetin e prezakimit, si dhe rrethanat nen te cilat eshte kryer vepra penale e vjedhjes e qe ne kohen e sotme jane ne trend dhe aktuale, ngase kemi te bejme me dem material te shkaktuar ndaj te demtuarit si nje vlore te larte materiale per standardin jetesor, sipas data bazes te stacionit

policor ne Prižren, ndaj te njejtit jane inicuar disa raste penale, pra eshte perserites – recidivist i veprave penale te vjedhjes se rende, e si rrethane lethesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjelljen korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, ne kuptim te nenit 74, 75, 76 gjykata morri per baze edhe faktin se i akuzuari ka bashkepunuar me gjykaten, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar, i moshes relativisht i ri, i gjendjes se dobet ekonomike, i pa pune, andaj gjykata i shqiptoi denimin me burgim dhe me gjobe, sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi i denimit, prandaj i shqipton denimin me burgim efektiv si ne dispozitivin te aktakuzes ne kohezgjatje prej 2 vitesh dhe denimin me gjobe ne shume prej 600 eurove, i cili denim do te ekzekutohet pas plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se perqejgesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jet i kujdeshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla te karakterit penal.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPK-se.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr. 2033/2015 të dt. 20.12.2016**

**Sekretare Juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari**  
**Fatmir Krasniqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder ketij aktgjykimi palet e pakenaqura kane te drejte ankesa ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.

288/4. Rehiz  
3. Faksile  
1. Faksile  
06.03.17